



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 korrik 2021
Nr. ref.:RK 1817/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI77/21

Parashtrues

Halit Korenica

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML. nr. 30/2021, të 25 shkurtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Halit Korenica, nga Rahoveci (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 30/2021, të 25 shkurtit 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 prill 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 18 maj 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës, gjithashtu, e njoftoi edhe parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë formularin zyrtar të kërkesës së Gjykatës.
8. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
9. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit KSH77/21, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha për kryesues të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
10. Më 28 maj 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar të plotësuar të Gjykatës.

11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21 gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 30 qershor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe një person tjetër, E.L., më 5 qershor 2018, rreth orës 23:30, në Rahovec, kanë sulmuar personin e tretë, D.K., dhe me këtë rast ia morën në mënyrë të kundërligjshme telefonin e tij si dhe një shumë të caktuar parash.
14. Më 15 gusht 2018, Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ngriti aktakuzën PP/I. nr. 39/2018, kundër parashtruesit të kërkesës dhe bashkëkryerësit, personit E.L., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale *“të grabitjes nga neni 329 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së”*.
15. Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) mbajti 7 seanca të shqyrtimit gjyqësor me qëllim të vërtetimit të përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës dhe bashkëkryerësit, personit E.L.
16. Më 18 shtator 2020, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit PKR. nr. 39/18, e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe bashkëkryerësin, personin E.L., sepse *“në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së”*. Me Aktgjykimin PKR. nr. 39/18 të Gjykatës Themelore, parashtruesit të kërkesës i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, dhe me të njëjtin Aktgjykim, bashkëkryerësit, personit E.L., i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro.
17. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata Themelore theksoi: *“[...] kjo gjykatë nuk mund të pranoi konstatimet e mbrojtësit të akuzuarit (parashtruesit të kërkesës) se provat e parashtruar nuk kanë vërtetuar përgjegjësin penale të mbrojturit të tij sa i përket veprës të ngarkuar me aktakuzë lidhur me grabitjen nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së[...].*

[...]

Nga kjo gjendje faktike gjykata pa dyshim ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve E. L. dhe Halit Korenica (parashtruesi i kërkesës) të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të veprës penale, të grabitjes nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjendja faktike nga dispozitivi i aktgjykimit është vërtetuar nga provat të cilat janë bashkëngjitur në aktakuzë, e që kanë qenë të propozuara për tu nxjerrë si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sa i përket fajësisë Gjykata ka

gjete se në veprimet e të akuzuarve E. L. dhe Halit Korenica (parashtruesi i kërkesës) ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale grabitje nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.”

18. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës, brenda afatit ligjor, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit PKR. nr. 39/18 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se *“aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënë me arsyetimin, se nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe mes asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjeve të shkresave të lëndës dhe procesverbaleve”*. Për më tepër, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës shtoi në ankesë se *“...gjendja është vërtetuar gabimisht, sepse gjykata e shkallës së parë interpreton provat, por nuk i vlerëson ato. Mbrojtja po ashtu thekson faktin se edhe pse i dëmtuari ka deklaruar se ka qenë i kërcënuar nga i akuzuari, në shkresat e lëndës mungon thika si provë...”*.
19. Më 23 dhjetor 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 381/2020, refuzoi, si të pabazuara, pretendimet ankimore të mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, si dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
20. Përkitazi me pretendimet ankimore të paraqitura nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit gjeti se:

“i) pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë e që kanë të bëjnë me gjendjen faktike, Gjykata e Apelit gjen se nuk janë të bazuara, kjo për shkak se gjykata e shkallës së parë drejt dhe qartë ka arsyetuar se pse provat e administruara vërtetojnë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen...”

ii) Pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit (parashtruesit të kërkesës) se i akuzuari (parashtruesi i kërkesës) nuk ka pasur thikë dhe kjo asnjëherë nuk është vërtetuar sepse të akuzuarit nuk i është gjetur ndonjë thikë e as nuk ka ndonjë raport mjekësor për lëndimin e të dëmtuarit është i pabazuar, për faktin se nxjerrjen e thikës dhe gërvishtjen në këmbën e majtë e dëshmon i dëmtuari, e po ashtu sipas kualifikimit të veprës penale rezulton se të akuzuarit nuk janë akuzuar se veprën e kanë kryer me përdorimin e armës rezulton se të akuzuarit nuk janë akuzuar se veprën e kanë kryer me përdorimin e armës siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 329 të KPRK-së, por janë akuzuar se kanë kryer veprën e grabitjes me përdorimin e forcës që parashihet në paragrafin 1 të nenit 329 të KPRK-së. Andaj, ky pretendim i mbrojtjes nuk qëndron.”

21. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës, brenda afatit ligjor, paraqiti kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit PAKR. nr. 381/2020 të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se janë bërë *“shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën para. 1.12 në lidhje me nenin 370 të KPP-së dhe shkelje të ligjit penal nga neni 385 par. 1 nën para. 1.5 të KPP-së, se aktgjykimet nuk përmbajnë arsyetim të*

arsyeshëm, se janë kontradiktore, se nuk janë plotësuar kriteret ligjore të nenit 31 të KPK-së që vepra të konsiderohet si vepër penale në bashkëkryerje”.

22. Më 25 shkurt 2021, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit PML. nr. 30/2021, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore PKR. nr. 39/2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 381/2020.
23. Në arsyetimin e Aktgjykimit PML. nr. 30/2021, Gjykata Supreme theksoi:

“i) Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara [...]. Të dy aktgjykimet, ai i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të qartë, të kuptueshëm dhe të bazuar në ligj. Dispozitat janë në harmoni me vetveten dhe me arsyetimin, ndërsa vendimet mbështeten në prova të administruara dhe drejtë të vlerësuar, që do të thotë se janë paraqitur në mënyrë të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye merren si të provuara.

ii) Lidhur me pretendimet e të dënuarit se nuk janë plotësuar kriteret ligjore të cilat duhet medoemos duhet të plotësohen, veprimet të cilat duhen ndërmarrë, pasoja, lidhja objektive dhe subjektive, për të ekzistuar bashkëkryerja duke pretenduar se asnjë nga këto arsye ligjore nuk janë plotësuar, nuk do të thotë se këto veprime duhet të ndërmerren ekskluzivisht para kryerjes së veprës penale, apo se duhet të ekzistojë marrëveshja formale për këtë, bashkëkryerja mund të ndodhë edhe në momentin e kryerjes së veprës penale pa ekzistuar marrëveshja paraprake apo pa kryer ndonjë veprim të caktuar në këtë drejtim.

iii) Pretendimet se nuk dihet se çka u bë me telefonin dhe paratë e marra si dhe se çka ka përfituar ky nga kjo vepër penale, nuk ka raport mjekësor për lëndimin e të dëmtuarit, nuk e përjashtojnë ekzistimin e veprës panel dhe përgjegjësinë penale të të dënuarit dhe se nuk është kontestuese se në të gjitha deklaratat e personave të involvuar në këtë rast rezulton se telefoni dhe paratë janë marrë, nga se po të mos ishte (marrja) e telefonit dhe parave nuk do të ekzistonte as vepra penale e grabitjes e paraparë me nenin 329 par. 1 të KPRK.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

i) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

25. Parashtruesi i kërkesës, në mbështetje të këtyre pretendimeve, shton se “aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës janë kundërligjorë, meqenëse të

njëjtat Aktgjykime janë marrë në kundërshtim me nenin 2 të Kodit të procedurës penale të Republikës së Kosovës, si dhe në kundërshtim me nenin 385 par. 1 pika 1.1 të KPPRK-së meqenëse në rastin konkret me asnjë provë nuk është vërtetuar se e kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallë fajtorë dhe dënuar me dënim me gjobë dhe dënim burgu. Pra në veprimet e mija kanë qenë të përmbushura elementet e veprës kundërvajtëse prishje e rendit dhe qetësisë publike, e jo të veprës penale për të cilën janë akuzuar, meqenëse nuk është vërtetuar me asnjë provë se kanë përdorë armë, pra mungon korpora delikti dhe nuk është vërtetuar me asnjë provë se të dëmtuarit i kanë shkaktuar lëndime”.

26. *Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se “Gjykata e Apelit të Kosovës duke vendosur lidhur me ankesë dhe në arsyetim të aktgjykimit (faqja e 4), par. 3, arsyeton se i akuzuari (parashtruesi i kërkesës) nën kërcënimin e thikës e ka gërvishitur të dëmtuarin, ndërsa në procesverbalin e datës 24.07.2020 (faqja 8 (11)) në pyetjen e prokurorit se natën kritike a ke pasë dika me vete, i jamë përgjigjur Jo, ndërsa i dëmtuari Denis nuk bënë vërejtje (faqja 9 (11)), parë në rastin konkret edhe nga përgjigja e të dëmtuarit vërtetohet se nuk kamë pasë thikë”.*
27. *Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se “Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur lidhur me Kërkesë në arsyetim të aktgjykimit, faqja 3, parag. 4, arsyeton se ... rezulton se telefoni dhe paratë janë marrë, ngase po të mos ishte (marrja e) telefonit dhe parave nuk do të ekzistonte as vepra penale e grabitjes, nga neni 329 par. 1 të KPRK-së. Me rastin e marrjes në pyetje në cilësi të dëshmitarit i dëmtuari në pyetje të prokurorit se cili prej të akuzuarve ja ka marrë telefonin, pakon e cigareve dhe paret që ishin në pako, përgjigjet i akuzuari E. L. (procesverbali i datës 15.08.2020 (faqja 5 (12)) parag. 6)”.*

ii) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës

28. *Parashtruesi gjithashtu pretendon edhe shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, megjithatë, për këtë nuk ofron ndonjë arsyetim më të hollësishëm se si ndodhi shkelja e këtij neni, por thekson se përmes aktgjykimeve është shkelur edhe “neni 24 - Barazia para Ligjit, përkatësisht garancioni kushtetues se të gjithë janë të barabartë para Ligjit, se çdo kush e gëzon të drejtën e mbrojtjes së paraparë ligjore, pa diskriminim”.*
29. *Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë që kërkesa e tij të deklarohet e pranueshme, që Gjykata të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, ai kërkoi që Gjykata ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 30/2021, të 25 shkurtit 2021, dhe, rrjedhimisht, ta ndalojë ekzekutimin e dënimit derisa të merret një vendim lidhur me ankesën kushtetuese.*

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

32. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...].”

33. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 30/2021, të 25 shkurtit 2021, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

34. Gjykata i referohet edhe rregullit 39 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

35. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, rastin KIO4/21, parashtuese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, shih, gjithashtu, rastin KI175/20, parashtuese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
36. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar” dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Papranueshmërisë të 31 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita, A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, shih, gjithashtu, rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).
37. Në këtë kontekst, dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht, për të vlerësuar në rrethanat e këtij rasti nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht, do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilat, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
38. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës, në thelb, pretendon dy lloje të shkeljeve, dhe atë i) shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe ii) shkelje të pretenduara të nenit 24 të

Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata në vazhdim do t'i shqyrtojë këto pretendime veç e veç.

i) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

39. Duke u kthyer në rastin konkret, Gjykata rikujton se thelbi i rastit ka të bëjë me faktin se parashtruesi i kërkesës është dënuar me 2 vite burg në procedurën gjyqësore në të cilën gjykatat vërtetuan se ai “*në bashkëkryerje ka kryer veprë penale të grabitjes nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*”.
40. Lidhur me këtë, Gjykata, fillimisht, rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka as juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës (shih, në këtë drejtim, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
41. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991, shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI110/19, cituar më lart, paragrafi 41).
42. Në rastin konkret, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës e konsideron problematike pikërisht faktin se gjykatat gjatë procedurës e kanë shkelur nenin 2 të Kodit penal (në tekstin e mëtejshëm: KP), si dhe nenin 385 paragrafin 1 pikën 1.1 të KPPRK-së, në atë mënyrë që e dënuan për një veprë penale pa prova. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se në këtë mënyrë është shkelur neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
43. Më konkretisht, shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës e sheh në faktin se në veprimet e tij ekzistojnë të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse “*Prishja e rendit dhe qetësisë*” dhe jo të veprës penale për të cilën është akuzuar dhe dënuar me vonë me aktgjykimet e gjykatave. Për më tepër, parashtruesi konsideron se në procedurat gjyqësore nuk është vërtetuar se ai e ka përdorur armën (thikën) për të kryer veprën penale, dhe rrjedhimisht, sipas tij, nuk ekziston asnjë provë vendimtare e cila përcakton kualifikimin juridik të veprës së kryer. Në këtë mënyrë, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, është shkelur neni 2 i KP-së, si dhe neni 385 paragrafi 1 pika 1 të KPPRK-së.
44. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se neni 2 i KP-së, në pjesën relevante, thotë:

“Neni 2. Parimi i ligjshmërisë

- 1. Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj.*
- 2. Askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një veprë nëse para kryerjes së veprës ligji nuk e përcakton veprën si veprë penale dhe nuk parasheh sanksion penal ose masa të trajtimit të detyrueshëm për atë veprë.*
- 3. Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit i cili hetohet, ndiqet ose shpallet fajtor.”*

45. Ndërsa neni 385 paragrafi 1 pika 1 të KPPRK-së thotë:

“Neni 385 [Shkelja e ligjit penal]

1. Shkelje e ligjit penal ekziston kur:

- 1.1. vepra për të cilën i akuzuari ndiqet nuk është veprë penale;”*
- [...]*

46. Gjykata, duke i ndërlidhur pretendimet e parashtruesit të kërkesës me faktet e rastit konkret, gjen se për Gjykatën nuk është i kontestueshëm fakti se parashtruesi i kërkesës e ka kryer veprën, meqenëse ai vetë deklaroi në kërkesë se e ka kryer të njëjtën. Por, për parashtruesin është i kontestueshëm kualifikimi i veprës, i cili, sipas tij, është i gabuar, përkatësisht se vetë vepra e kryer ka elemente të veprës kundërvajtëse, dhe jo të veprës penale për të cilën ishte dënuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta.
47. Lidhur me këtë, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Themelore, e cila përcaktoi kualifikimin e veprës, si dhe përgjegjësinë e tij për të njëjtën, paraqiti argumente si në lidhje me formulimin dhe kualifikimin juridik të veprës, ashtu edhe në lidhje me faktin se në vetë veprën mungon prova vendimtare e cila përcakton figurën e veprës, dhe për këtë arsye ai konsideron se në vetë veprën ekzistojnë elementet e veprës kundërvajtëse dhe jo të një vepre penale.
48. Gjykata vëren se Gjykata Themelore, në mbështetje të këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, konkludoi se *“nga kjo gjendje faktike gjykata padyshim ka vërtetuar se në veprimet e të akzuarit E. L. dhe parashtruesit të kërkesës të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të veprës penale, të grabitjes nga neni 329 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Gjendja faktike nga dispozitivi i aktgjykimit është vërtetuar nga provat të cilat janë bashkëngjitur në aktakuzë, e që kanë qenë të propozuara për tu nxjerrë si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor”*.
49. Më tej, Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi i kërkesës i ka ngritur të njëjtat pretendime ankimore edhe para Gjykatës së Apelit, duke e vënë në plan të parë faktin se nuk ekzistojnë provat dhe për këtë arsye nuk ekziston as vepra penale për të cilën ai ishte dënuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

50. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit, duke analizuar pikërisht këtë pretendim, konkludoi se *“të akuzuarit nuk janë akuzuar se veprën e kanë kryer me përdorimin e armës siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 329 të KPRK-së, por janë akuzuar se kanë kryer veprën e grabitjes me përdorimin e forcës që parashihet në paragrafin 1 të nenit 329 të KPRK-së [...]”*.
51. Nga kjo rezulton se për Gjykatën e Apelit, mosekzistimi (i thikës) si provë, mbi të cilin parashtruesi e kërkesës e ndërtoi mbrojtjen e tij, nuk ishte vendimtar në përcaktimin e kualifikimit të veprës. Më konkretisht, pikërisht mosekzistimi i kësaj prove çoi në faktin se gjykatat arritën në përfundim se parashtruesi i kërkesës kishte kryer veprën penale *“nga neni 329 paragrafi 1”* dhe jo veprën penale *“nga neni 329 paragrafi 3”*.
52. Gjykata rikujton se dispozitat përkatëse të nenit 329 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të KPRK-së, përcaktojnë:

“Neni 329 Grabitja

1. Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

[...]

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë (7) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.”

53. Gjykata më tej gjen se të njëjtat pretendime ankimore janë trajtuar edhe nga Gjykata Supreme në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ku ajo i vërtetoi si të drejta të gjitha pretendimet ankimore tashmë të shqyrtuara nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, duke konkluduar *“se qëndrimet e gjykatave se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale nga neni 329 paragrafi 1 i KP-së, janë plotësisht të drejta”*.
54. Prandaj, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta gjatë gjithë procedurës iu janë përmbajtur principeve dhe parimeve të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç parashikohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe se kanë vepruar në frymën e dispozitave përkatëse të KPRK-së gjatë përcaktimit dhe kualifikimit të veprës, dhe nga kjo gjithashtu mund të konkludohet se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të KP-së, as të nenit 385 paragrafi 1 pika 1 të KPPRK-së, siç pretendon parashtruesi në kërkesë.
55. Gjykata rrjedhimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka pasur përfitimet e procedurës kontradiktore; ai ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës të paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; e ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të

cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës; arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, prandaj, procedura, shikuar në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim i 7 korrikut 2019, paragrafi 42; si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).

56. Andaj, Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të legjislacionit penal, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55, shih, gjithashtu, në këtë aspekt, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
57. Përfundimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit në fuqi me rastin e kualifikimit të veprës janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërtë*”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

ii) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës

58. Sa i përket shkeljeve të të drejtave të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) e pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih, gjithashtu, *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues *Ministria e Punës dhe*

59. Në rastin konkret, parashtruesi pretendon edhe shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, por në lidhje me këtë nuk ofron në kërkesë ndonjë arsyetim më të hollësishëm se si është shkelur ky nen, por thekson se përmes aktgjykimeve është shkelur edhe *“neni 24 – Barazia para Ligjit, përkatësisht garancioni kushtetues se të gjithë janë të barabartë para Ligjit, se çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes së paraparë ligjore, pa diskriminim”*.
60. Përkitazi me këto pretendime, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet respektive, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81; KI166/20, cituar më lart, paragrafi 52; KI04/21, cituar më lart, paragrafët 38-39).
61. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi që këto pretendime kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (iii) pretendime *“të pambështetura ose të paarsyetuara”*, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato ishin shkelur. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

62. Andaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet e të drejtave të garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi si qartazi të pabazuara, sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të *“shkallës së katërt”*; dhe kategorinë (iii) pretendime *“të pambështetura ose të paarsyetuara”*. Prandaj, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në tërësi si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më seancën e mbajtur më 30 qershor 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka Nimani